# Sherr mes fqinjve në Pogradec, 58-vjeçari qëllon me armë zjarri çiftin e bashkëshortëve, policia parandalon krimin

07 Qershor, 2020 09:06 |



Madhësia e tekstit:

Policia ka parandaluar përshkallëzimin e një sherri në Pogradec, i cili mund të kishte pasoja të rënda. Në pranga ka rënë një 58-vjeçar, i cili pas një konflikti me fqinjin e tij dhe bashkëshorten e këtij të fundit ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të tyre.

Fatmirësisht, policia ka ndërhyrë në kohë, duke shpëtuar çiftin dhe arrestuar 58-vjeçarin, ndërsa ka sekuestruar pistoletën me 4 fishekë.

**Njoftimi i policisë:**

Pogradec

Ndërhyrja në kohë e policisë, parandalon përshkallëzimin e mëtejshëm të një konflikti.

Tenton të vrasë me armë zjarri fqinjët e tij, kapet dhe arrestohet në flagrancë një 58-vjeçar.

Sekuestrohet arma e zjarrit pistoletë me 4 fishekë të cilën autori e posedonte pa leje.

Pas marrjes së njoftimit se në fshatin Buçimas, dy familje fqinje po konfliktoheshin me njëra-tjetrën, shërbimet e Komisariatit të Policisë Pogradec në bashkëpunim me Forcat e Posaçme Operacionale në DVP Korçë, kanë shkuar menjëherë në vendngjarje ku konstatuan se:

Shtetasi I. H., 58 vjeç, banues në fshatin Buçimas, pasi ishte konfliktuar për motive të dobëta me fqinjin e tij I. J., 52 vjeç dhe bashkëshorten e këtij të fundit, kishte qëlluar me armë zjarri tip pistoletë "Zastava" në drejtim të tyre.

Falë reagimit dhe ndërhyrjes në kohë të policisë, u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i autorit të dyshuar të ngjarjes si edhe parandalimi i përshkallëzimit të mëtejshëm të këtij konflikti, i cili mund të sillte pasoja të rënda për jetën.

Në cilësinë e provës materiale 58-vjeçarit, iu gjet e sekuestrua arma e zjarrit me 4 fishekë në krëhërin e saj.

Materialet i kaluan Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec për veprat penale "Vrasja me dashje mbetur në tentativë" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".

**(BalkanWeb)**

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

**Etiketa:** pogradec sherr

## TË NGJASHME

Sherr mes dy personave në Vlorë, njëri nxjerr armën për të qëlluar, por...
07 Qershor, 2020

Sherri për ullinjtë mes dy familjeve në Berat, policia zbardh detaje: U konfliktuan me mjete të forta e prerëse, rëndë një person
07 Qershor, 2020

Shfaq Komentet (0)

## TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Skandali seksual në Kakavijë, përjashtohet nga Policia e Shtetit punonjësi i pikës kufitare
08 Qershor, 2020

Ish-shefi i policisë, Erzen Breçani: Arma e përdorur për të eliminuar Ardjan Çapjan përdoret nga forcat speciale, por...
08 Qershor, 2020

Atentati ndaj Çapjas/ Ish-zyrtari i lartë i policisë: Dihet që kjo familje ka konflikte, agjentët kriminalë dhe hetuesit duhet të...
08 Qershor, 2020

Falsifikuan dokumente shëndetësore, kallëzohet penalisht ish-kreu i AKU dhe katër mjekë
08 Qershor, 2020

Atentati ndaj Ardjan Çapjas/ Gazetarja: Një 8-vjeçar dëshmitari i vetëm, foli për tre autorë. Ja çfarë pa
08 Qershor, 2020

Si paraqitet gjendja e Ardian Çapjes? Gazetarja Klodiana Lala jep detajet: Në gjendje kritike, po flitet edhe për intubim
08 Qershor, 2020

## KATEGORIA VIDEO

"Zgjedhorja", analisti Skënder Minxhozi bën parashikimin: S'do preket financimi i paligjshëm në fushatë
08 Qershor, 2020

Ish-shefi i policisë, Erzen Breçani: Arma e përdorur për të eliminuar Ardjan Çapjan përdoret nga forcat speciale, por...
08 Qershor, 2020

Atentati ndaj Çapjas/ Ish-zyrtari i lartë i policisë: Dihet që kjo familje ka konflikte, agjentët kriminalë dhe hetuesit duhet të...
08 Qershor, 2020

Si paraqitet gjendja e Ardian Çapjes? Gazetarja Klodiana Lala jep detajet: Në gjendje kritike, po flitet edhe për intubim
08 Qershor, 2020

Tërmeti, sizmologu Duni: Paslëkundjet do të vijojnë, njerëzit nuk duhet të futen në strukturat me vështirësi ekuilibri
08 Qershor, 2020

"Rotacioni i mundshëm me sistemin aktual", Nazarko: Rama vendoset në krizë kur ka përballë lider propozues, Basha e ka treguar këtë muajt e fundit
08 Qershor, 2020

Download on the App Store | GET IT ON Google Play

Kerko ketu

## LAJMET E FUNDIT

Alfred Peza: PS ka qenë e qartë, nuk ka kërkuar dhe premtuar ndryshim të sistemit zgjedhor
08 Qershor, 2020

"Zgjedhorja", analisti Skënder Minxhozi bën parashikimin: S'do preket financimi i paligjshëm në fushatë
08 Qershor, 2020

Bilanci i Kurtit në 4 muaj qeverisje në Kosovë, 'fshesa' për 60 zyrtarë të lartë
08 Qershor, 2020

Si ta kuptoni nëse keni tepricë hekuri, çfarë i ndodh trurit dhe organizmit
08 Qershor, 2020

Kryediplomati serb shpreh gatishmërinë për dialogun me Kosovën, zbulon kushtet që duhet t'i paraprijnë bisedimeve
08 Qershor, 2020

Vrasja e tmerrshme e George Floyd, ish-polici del për herë të parë në gjykatë, i rritet garancia në 1.25 milionë USD
08 Qershor, 2020

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb



© 2020 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.